



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 26 tetor 2016, në mbledhjen e XIX (njëzetënentë) të Komitetit për Komunitete.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 11.35.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Shaban Ahmeti, kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: Bahri Selimi, Shaban Osmani, Mefail Rama, Radisav Perović dhe Xhafer Ademi, ndërsa mungoi Xhevdet Beselica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Fadil Babatinca, Policia e Kosovës, Bashkim Bajrami, Policia Kufitare, Bekim Karaxhija, OSBE, dhe dy përfaqësues të KFOR – LMT, Xhavit Fejza dhe Nevzat Qorrolli, UNMIK.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri.

2. Vlerësimi i realizimit të Planit të punës të Komitetit për Komunitete për periudhën nëntëmujore dhe identifikimi i çështjeve me rëndësi për shqyrtim dhe ndërmerre të aktiviteteve deri në fund të vitit 2016

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, theksoi, në vazhdimësi kemi bërë përpjekje për realizimin e planit të punës për këtë vit, përveç tjerash i kemi vizituar të gjitha shkollat në qytet dhe fshatra në të cilat mësimet i vijojnë nxënësit e komuniteteve RAE dhe po ashtu i kemi vizituar edhe pjesëtarët e komunitetit serb në Metergoc – lagjen e Sekiraqëve.

Gjithashtu kemi bërë vizita në lagjet e qytetit Xhafer Meta dhe Ali Ajeti në të cilat jetojnë pjesëtarë të komuniteteve RAE, pastaj në batllavë dhe Orllan, vizita në të cilat kemi biseduar për brengat e atyre qytetarëve dhe sipas mundësive ju kemi ndihmuar në zgjidhjen e problemeve të ndryshme.

Në vitin e kaluar kemi bërë përpjekje që t'i ndihmojmë me një sasi të druve për djegie disa familje në gjendje të rëndë sociale mirëpo nuk kemi pasë sukses, çështje për të cilën do të angazhohemi edhe këtë vit. Edhe këtë vit, si shumë e shumë vite të mëparshme, janë siguruar tekstet shkollore falas për 29 nxënës të

komuniteteve RAE dhe 44 nxënës të komunitetit shumicë të cilët mësimet i vijojnë në Shkollat Filllore të Mesme të Larta, për këtë ndihmë e falënderoj Drejtorinë e Arsimit.

Disa çështje të parapara me Planin e punës nuk kemi mund t'i realizojmë për shkak të mungesës së mjeteve financiare.

Vitin e kaluar në projekte të ndryshme janë punësuar një numër i punëtorëve sezonal por këtë vit nuk kemi mund të punësojmë askënd.

z. Shaban Osmani, theksoi, lidhur me çështjen për të cilën jemi duke debatuar mund të them se ne anëtarët e Komitetit për Komunitete rreth 80% të synimeve me Planin e punës dhe obligimet tjera i kemi realizuar. Në fillim të vitit të ri shkollor i kemi vizituar të gjitha shkollat në të cilat vijojnë mësimet nxënësit e komuniteteve RAE dhe nga ana e drejtorëve të shkollave dhe kujdestarëve të klasave jemi informuar për kushtet e vijimit të mësimëve në shkollat përkatëse. Gjithashtu kemi vizituar lagjet në të cilat jetojnë pjesëtarët e komuniteteve RAE dhe jemi informuar për problemet dhe brengat e atyre komuniteteve dhe në kuadër të kompetencave tona kemi ndërmarr veprimet për zgjidhjen e çështjeve të ndryshme të komuniteteve pakicë. Kemi vizituar edhe lagjen e Sekiraqëve në fshatin Metergoc, përkatësisht pjesëtarët e komunitetit serb ku jemi informuar për problemet me të cilat përballen ata qytetarë në veçanti për vështirësitë lidhur me kalimin e vijës kufitare me rastin e ardhjes dhe vajtjes së familjarëve, e gjithë kjo për shkak të mungesës së vendkalimit kufitar, ne kemi bashke ndje për shqetësimet e tyre por mirëpo kjo çështje nuk është në kompetencë të nivelit lokal por të atij qendror.

Sa i përket bursave për nxënës dhe student të komuniteteve RAE, sa unë jam në dijeni, vitin e kaluar, të gjithë ata kanë marrë bursa, ndërsa për këtë vit shkollor të gjithë të interesuarit i kanë paraqitur kërkesat dhe besoj se përgjigja në ato kërkesa do të jetë pozitive.

Po e përsërisë sa i përket kompetencave në kuadër të këtij Komiteti ne i kemi bërë të gjitha përpjekjet për realizimin e tyre dhe do të vazhdojmë aktivitetet për përmbushjen e synimeve të parapara Planin e punës dhe përgjegjësi të tjera ligjore.

z. Xhafer Ademi, theksoi, nuk dëshiroj t'i përsërisë çështjet të cilat i përmenden parafolësit dhe shtoi, ky Komitet në kuadër të mundësive dhe kapaciteteve punuar në bazë të mundësive që i ka. Ne jemi munduar të punojmë dhe mund të them se i kemi arritur disa suksese, suksese të cilat i përmendën parafolësit, në veçanti sigurimi i teksteve shkollore për nxënësit e Shkollave Filllore të Mesme të Larta. Gjatë vizitave jemi informuar për problemet e komuniteteve RAE dhe është evidente se ne ato çështje i kemi paraqitë në Drejtorinë kompetente për shqyrtim të mëtejshëm.

z. Bahri Selimi, theksoi, sa i përket realizimit të Planit të punës të këtij Komiteti, pas diskutimeve të parafolësve, çka do që të thuhet vetëm do të përsëriten gjërat ngase në mënyrë të qartë u tha se në kuadër të përgjegjësi dhe mundësive është punuar dhe janë përmbushur kërkesat e pjesëtarëve të komuniteteve RAE. Objektivat e parapara për këtë vit, përkatësisht këtë nëntëmujor, mund të them se i kemi përmbushur me sukses, përveç çështjeve apo kërkesave për ofrimin e ndihmave të ndryshme.

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, theksoi, në organizim të OSBE së kemi marrë pjesë në takimin e mbajtur me përfaqësuesit e Komiteteve për Komunitete të komunave që i përkasin regjionit të Mitrovicës.

z. Bekim Karaxhija, OSBE, theksoi, ndoshta për shkak të modestisë gjatë debatit nuk u përmenden trajnimet në të cilat janë mbajtur me pjesëtarë të komuniteteve RAE të organizuara nga OSBE, por gjithherë në koordinim me Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe Komitetin për Komunitete.

Përndryshe ne si OSBE kemi bashkëpunim të shkëlqyeshëm dhe vetëm fjalë të mira për Komitetin për Komunitete dhe Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe Komitetin për Komunitete.

z. Liman Zeqiri, theksoi, ju përgëzoj për punët dhe angazhimet e bëra dhe shtoi, në mbledhjet e mbajtura ky Komitet i ka shqyrtuar çështjet e parapara me Planin e punës, Plan i punës mjaftë i mirë i cili, sipas mendimit tim, do duhej të ishte model edhe për komunat tjera.

Në cilësinë e shefit të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, jam mirënjohës për bashkëpunimin dhe raportet e shkëlqyera me këtë Komitet.

Ka kohë që marrë pjesë në mbledhjet e këtij Komiteti dhe duke u bazuar në këtë lirshëm ju them se ky Komitet mua më së tepërmi më pëlqen për harmoninë e brendshme dhe transparencën e plotë për të mirat, dobësitë dhe lëshimet.

Mbi bazën e mundësive dhe kapaciteteve, Ky Komitet, ka bërë përpjekje të ofroj ndihmat e mundshme dhe të jetë një urë lidhëse në mes të qytetarëve dhe mekanizmave lokale dhe qendrore, duke përfshirë edhe OJQ – të.

Podujeva është model i raporteve ndëretnike, ky është realitet andaj e them pa kurrfarë rezerve.

Krejtësisht në fund, unë jam i mendimit se për çështjen për të cilën jemi duke debatuar ka qenë mirë që paraprakisht, sipas rregullit, të kishim një informatë në formë të shkruar, formë e cila e ka efektin e vet.

3. Të ndryshme

z. Xhafer Ademi, theksoi, në bazë të angazhimit thuajse një vjeçar kam arritur që në Komunën tonë të sjell një projekt për rindërtimin e shtëpive të komuniteteve pakicë, në kuadër të këtij projekti më e mira është se nuk ka numër të kufizuar për rindërtimin e shtëpive, mirëpo kushti i vetëm është që donatori i jep 70% të mjeteve financiare, ndërsa Komuna i jep 30%. Lidhur me realizimin e këtij projekti kam biseduar me nënkryetarin e Komunës, me të cilin jemi marrë vesh se unë do ta ftoj përfaqësuesin e donatorit e ai do të takohet me të dhe do të shqyrtojnë të gjitha mundësitë për realizimin e këtij projekti, kuptohet ky projekt do të realizohet nëse Komuna ka mjete buxhetore.

z. Liman Zeqiri, theksoi, në cilësinë e shefit të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, jam informuar për projektin e cekur nga parafolësi, lidhur me këtë kam kontaktuar me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, përkatësisht me znj. Arbresha Latifi, koordinatorë për çështje të strehimit, me të cilën kam biseduar në detaje për këtë projekt të cilin e ka mirëpritur dhe unë duke e respektuar hierarkinë i kam sugjeruar ta informoj drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale i cili për këtë projekt do të konsultohet me Kryetarin e Komunës.

Sipas projektit në fjalë parashihet ndërtimi, rindërtimi apo rinovimi i shtëpive, mirëpo me rëndësi është që të përgatitet dokumentacioni i nevojshëm dhe në afatin e caktuar, që është kohë e shkurtë, të konkurrojmë për përfitim të këtij projekti.

Kemi debatuar në këtë Komitet për Komunitete por edhe në instanca të tjera, dhe kemi konstatuar se në kohën kur Komuna me buxhet të vetin ndërtonte shtëpi të karakterit kemi social, problemi më i madh sa i përket komuniteteve RAE ka qenë se pjesëtarët e atyre komuniteteve të cilët kanë pasë nevojë për sigurimin e çështjes së strehimit nuk kanë poseduar pronë të paluajtshme – truall për ndërtimin e shtëpisë.

z. Xhafer Ademi, theksoi, sa unë jam i informuar donatori do të ndërtoj, rindërtoj dhe rinovojë aq shtëpi sa Komuna ka mjete buxhetore me mbuluar 30% të punimeve të përgjithshme.

z. Liman Zeqiri, theksoi, e përmenda edhe më parë se ne fillimisht duhet të përgatitim dokumentacionin e nevojshëm dhe të aplikojmë më së largu deri më 17 nëntor 2016, datë kur është afati i fundit.

Mbledhja përfundoi në orën 12.05'.

**Procesverbalin e mbajti
Faik Gashi**

**Nr. 01-006-79928
Podujevë,
26 tetor 2016**

**Kryesuesi i Komitetit
Shaban Ahmeti**